



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 1080/3 Prot.

Tiranë, më 06.07. 2026

V E N D I M

Nr. 181, datë 06.07.2026

Bazuar në nenin 32 dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 137 Regj., datë 08.06.2026¹ e shtetases znj. A. A., kundër Shkollës së Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj dhe znj. V. Ç., në cilësinë e Drejtoreshës së Shkollës së Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj, në të cilën pretendoni diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shëndetësore”, “perkatësisë prindërore”, “përgjegjësisë prindërore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj. A. A., në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se: *Gjatë gjithë vitit shkollor 2025–2026 është përballur me një trajtim të vazhdueshëm të pabarabartë dhe diskriminues nga Shkolla e Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj dhe drejtoresha e saj, V. Ç. Sipas saj, që nga fillimi i vitit shkollor është përjashtuar nga procese të rëndësishme institucionale, nuk është informuar apo përfshirë në Komisionin e Etikës dhe Disiplinës, ndërsa kërkesat dhe ankesat e saj zyrtare nuk janë protokolluar dhe nuk kanë marrë përgjigje, ndryshe nga praktika e ndjekur ndaj punonjësve të tjerë.*

¹ Plotësuar në datën 26.06.2026, me shkresën nr.1080/2 prot.,.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

Një pjesë qendrore e ankesës lidhet me ndryshimin e listëpagesës dhe zbritjen e ditëve të punës pas zbatimit të Vendimit nr. 252, datë 01.04.2026. Ankuesja pretendon se mungesat për datat 03.03.2026 dhe 24.03.2026 ishin të justifikuara me dokumentacion mjekësor dhe përkonin me paraqitjen e saj në seanca gjyqësore, ndërsa vendimi është marrë pa u dëgjuar paraprakisht dhe në kundërshtim me procedurat administrative. Ajo pretendon gjithashtu se listëpagesa është ndryshuar në mënyrë të pasaktë, duke sjellë pasoja financiare më të mëdha se ato të përcaktuara në vetë vendimin.

Ankuesja pretendon se nuk i janë siguruar kushtet minimale dhe baza materiale për zhvillimin e lëndës së Edukimit Fizik, megjithëse ka zhvilluar mësim me ngarkesë të plotë për klasat I–XII. Gjithashtu, ajo pretendon se është trajtuar në mënyrë më të pafavorshme se kolegët në shpërndarjen e orarit, ngarkesës mësimore, aktiviteteve dhe përgjegjësi, si edhe është përjashtuar nga trajnimet, projektet, orët e hapura dhe veprimtaritë profesionale të organizuara nga institucioni.

Sipas ankueses, trajtimi i diferencuar është shfaqur edhe në aspektin social dhe personal, pasi ajo është përjashtuar nga aktivitetet sociale dhe festive të shkollës, i është kufizuar aksesimi në faqen zyrtare të institucionit për publikimin e aktiviteteve të zhvilluara me nxënësit dhe nuk i është garantuar hapësira minimale për ruajtjen e materialeve të punës. Ajo pretendon gjithashtu se nuk është lejuar të marrë pjesë në aktivitetet ku konkurronin fëmijët e saj, ndonëse mësues të tjerë kanë përfutur autorizime të ngjashme në rrethana të krahasueshme.

Ankuesja pretendon se vendimi administrativ është ndikuar nga një konflikt interesi, pasi Drejtoresha e ZVAP Tropojë, Sh. B., e cila kishte iniciuar një proces gjyqësor personal kundër saj, ka nxjerrë vendimin administrativ që preku marrëdhënien e saj të punës dhe pagesën. Sipas ankueses, drejtoresha e shkollës, V. Ç., nuk ka ushtruar kompetencën e saj në mënyrë të pavarur, por ka zbatuar urdhrin e ZVAP. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja deklaron se disponon një regjistrim audio ku drejtoresha shprehet se ka vepruar nën urdhrin e Shotë Bashajt dhe i ka kërkuar ankueses dorëheqjen nga detyra.

Për të mbështetur pretendimet e saj, ankuesja ka paraqitur dokumentacion, përfshirë korrespondencë elektronike, kërkesa zyrtare, dokumente të shkollës, vendimin administrativ, listëpagesën, listat e prezencës, orarin mësimor, regjistrimin audio dhe dokumente të proceseve gjyqësore në zhvillim. Ajo pretendon se të gjitha këto elemente, të marra së bashku, dëshmojnë një model të vazhdueshëm trajtimi të pabarabartë, përjashtimi dhe diskriminimi në marrëdhënien e saj të punës.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri ndër të tjera:

- 1- Konstatimin e diskriminimit, trajtimit të pabarabartë dhe/ose viktimizimit, nëse këto pretendime rezultojnë të provuara gjatë hetimit administrativ.
- 2- Urdhërimin e marrjes së masave për ndërprerjen e praktikave diskriminuese, eliminimin e pasojave të tyre dhe garantimin e trajtimit të barabartë në të ardhmen.

- 3- Marrjen e çdo mase tjetër të parashikuar nga ligji për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe njoftimin tim për çdo veprim procedural dhe vendimmarrje të marrë gjatë shqyrtimit të kësaj ankese.

I. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

Në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës, me shkresën nr. 2080/1 prot., datë 12.06.2026, i është kërkuar ankueses të depozitojë informacion dhe dokumentacion plotësues lidhur me çështjen, duke i sqaruar se pretendimet e saj duhet të specifikohen nëse i drejtohen Drejtoreshës së Shkollës Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj në cilësinë institucionale dhe/ose personale, si dhe të evidentohen veprimet konkrete të pretenduara dhe provat mbështetëse. Gjithashtu, i është kërkuar të japë sqarime të detajuara mbi vendimin nr. 252, datë 01.04.2026 dhe rolin e pretenduar të drejtoreshës në nxjerrjen dhe zbatimin e tij, si dhe të paraqesë lidhjen shkakësore ndërmjet karakteristikave të pretenduara diskriminuese dhe trajtimit të pretenduar.

Po ashtu, i është kërkuar dokumentacioni mjekësor i plotë dhe prova mbi dijeninë e institucionit për gjendjen shëndetësore, sqarime mbi pretendimet për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike dhe përgjegjësisë prindërore, si dhe prova krahasuese për trajtim të diferencuar ndaj kolegëve të tjerë. Në vijim, është kërkuar dokumentacion mbështetës për pretendimet mbi refuzimin e protokollimit të shkresave, rrethanat dhe përmbajtja e një regjistrimi audio të pretenduar, si dhe dokumentacion mbi ndryshimet në listëpagesa dhe pasojat ekonomike të pretenduara. Gjithashtu, është kërkuar informacion nëse ankuesja i është drejtuar institucioneve të tjera ose gjykatave, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës që konsiderohet i nevojshëm.

Në përfundim, është theksuar se dokumentacioni i depozituar duhet të jetë i plotë, i qartë dhe i lexueshëm, duke mundësuar identifikimin e burimit, datës dhe përmbajtjes, ndërsa dokumentet e pjesshme ose të paqarta mund të mos merren në konsideratë për vlerësimin e pretendimeve.

Në përgjigje të kërkesës për plotësimin e ankesës, me shkresën nr. 2080/2 prot., datë 26.06.2026, pranë institucionit të Komisionerit është administruar një informacion i paraqitur nga ankuesja, në të cilin, në thelb, ajo ka parashtruar të njëjtat pretendime, fakte dhe prova të depozituara me ankesën fillestare.

Në këtë informacion, ankuesja nuk iu përgjigj kërkesave për sqarime të adresuara nga Komisioneri, duke mos i specifikuar pretendimet sipas kërkesës, si dhe nuk depozitoi dokumentacionin dhe provat plotësuese të kërkuara për verifikimin e tyre. Për rrjedhojë, nuk u plotësuan mangësitë e evidentuara gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës.

Pas analizimit sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Referuar pretendimeve të ankueses lidhur me ndryshimin e listëpagesës dhe zbritjen e dy ditëve të punës për datat 03.03.2026 dhe 24.03.2026, nga shqyrtimi i dokumentacionit administrativ rezulton se, fillimisht, këto ditë janë përfshirë në listëpagesën e ankueses dhe janë likuiduar nga Shkolla e Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj si ditë të rregullta pune.

Më pas, në vijim të verifikimeve të kryera nga ZVAP Tropojë, me shkresën nr. 77 prot., datë 27.03.2026, i është kërkuar Shkolla e Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj verifikimi i mungesave të konstatuara dhe trajtimi administrativ i tyre, në përputhje me kompetencat e institucionit.

Në zbatim të kësaj shkrese, drejtoresha e Shkolla e Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj ka nxjerrë Vendimin nr. 252, datë 01.04.2026, mbi bazën e të cilit është kryer ndryshimi i listëpagesës së ankueses dhe zbritja e dy ditëve të punës për datat 03.03.2026 dhe 24.03.2026.

Nga komunikimet në platformën WhatsApp Business rezulton se më datë 03.03.2026, ankuesja i ka dërguar Drejtoreshës një komunikim të drejtuar Gjykatës, në të cilin ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore, duke referuar si arsye gjendjen shëndetësore dhe pamundësinë për t’u paraqitur. Po në të njëjtën datë, ajo ka kërkuar edhe leje të justifikuar nga puna për shkak të pamundësisë objektive shëndetësore, duke bashkëlidhur dokumentacion mjekësor në formë rekomandimi mjeku dhe recete.

Nga komunikimet në platformën WhatsApp Business rezulton se më datë 22.03.2026, ankuesja ka njoftuar kërkesën për leje nga puna për arsye të vizitës mjekësore, duke bashkëlidhur një fotografi të një rekomandimi mjekësor.

Në vijim, më datë 24.03.2026, ankuesja ka ridërguar njoftim ku thekson se për shkak të gjendjes shëndetësore dhe pamundësisë objektive, kërkon sërish leje të justifikuar nga puna, duke referuar nevojën për mungesë në punë dhe duke bashkëlidhur dokumentacion mjekësor në formë rekomandimi/recete.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar me ankesën fillestare rezulton se ankuesja ka depozituar kopje të rekomandimeve mjekësore, të cilat mbajnë datat 16.02.2026 dhe 19.02.2026, si dhe rezervimet përkatëse, të datave 17.02.2026 dhe 23.02.2026. Nga verifikimi i këtyre dokumenteve konstatohet se datat e rekomandimeve dhe të rezervimeve nuk përkojnë me datat e mungesave të pretenduara të ankuses në punë. Për rrjedhojë, ky dokumentacion nuk provon lidhjen ndërmjet rekomandimeve mjekësore të paraqitura dhe mungesave që ankuesja pretendon se kanë qenë objekt i trajtimit të padrejtë.

Në lidhje me pretendimin e ankuses se në datat e pretenduara mungesa e saj ka qenë e justifikuar për arsye shëndetësore, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ajo nuk ka paraqitur raport mjekësor elektronik të lëshuar në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 4/1 dhe nenin 5 të Rregullores së Përbashkët nr. 2666/1, datë 21.6.2022/nr. 4360/1, datë 22.6.2022, *“Për kriteret, rregullat dhe procedurat e lëshimit të raporteve mjekësore elektronike për paaftësitë e përkohshme në punë”*, të ndryshuar, si dhe dispozitat përkatëse të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar. Në mungesë të një raporti mjekësor të vlefshëm sipas formës dhe procedurës së përcaktuar ligjore, nuk provohet në mënyrë të rregullt justifikimi i mungesave të pretenduara për arsye shëndetësore. *(Ankuesja ka paraqitur paraqitur një recetë mjekësore dhe rekomandim mjeku, por jo raport mjekësor elektronik)*

Rrjedhimisht, veprimi Shkollës së Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj, rezulton të jetë ndërmarrë në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Nga shqyrtimi i rrethanave të çështjes nuk rezultojnë elemente që të mbështesin pretendimet e ankuses. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se këto pretendime nuk gjejnë mbështetje të mjaftueshme në ligj, faktet e administruara dhe provat e shqyrtuara.

Referuar shkresës nr. 255/1 prot., datë 14.04.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës si dhe kërkesë-padisë të vënë në dispozicion nga ankuesja rezulton se ankuesja ka paraqitur kërkesë-padi pranë gjykatës kompetente, me objekt kundërshtimin e Vendimit nr. 252, datë 01.04.2026, dhe pasojave që ai ka sjellë në marrëdhënien e saj të punës. Për rrjedhojë, çështja e ligjshmërisë së këtij vendimi administrativ dhe e veprimeve të ndërmarra në zbatim të tij është bërë objekt i një procesi gjyqësor, ku do të shqyrtohen pretendimet e palëve dhe do të vlerësohet përputhshmëria e aktit me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me pretendimet e ankueses për trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm nga Shkolla e Bashkuar “Oso Dauti” Llugaj mbi bazën e shkaqeve të pretenduara si “*gjendja ekonomike*”, “*gjendja shëndetësore*”, “*përkatësia prindërore*” dhe “*përgjegjësia prindërore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk ka paraqitur shpjegime të arsyetuara dhe as nuk ka provuar me fakte dhe prova konkrete ekzistencën e një lidhjeje shkak-pasojë ndërmjet këtyre rrethanave dhe trajtimit të pretenduar nga ana e palëve të ankuara. Në këto kushte, nuk rezulton e provuar se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë ose të pafavorshme pikërisht për shkak të këtyre karakteristikave të pretenduara.

Komisioneri vlerëson se thjesht posedimi i një karakteristike të mbrojtur nga LMD nuk mjafton për të ngritur pretendim të vlefshëm diskriminimi — duhet të paraqiten fakte konkrete që prezumojnë si diferencën në trajtim, ashtu edhe lidhjen motivuese me shkakun e mbrojtur, standard ky që në rastin konkret nuk u përmbush.

Ankuesja ka paraqitur komunikime elektronike përmes email-it, platformave të mesazheve (WhatsApp/MSN), si dhe pamje nga rrjetet sociale, të cilat sipas saj lidhen me mënyrën e trajtimit të saj në marrëdhënien e punës. Megjithatë, këto materiale kanë natyrë të përgjithshme dhe lidhen kryesisht me komunikime të zakonshme për mbarëvajtjen e punës dhe organizimin e saj, pa përmbajtur elemente objektive që të provojnë se veprimet apo vendimet e kundërshtuara janë motivuar nga ndonjë prej shkaqeve të mbrojtura nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi.

Dokumentacioni i administruar nuk përmban elemente objektive që të mbështesin pretendimin për diskriminim, por lidhet kryesisht me kundërshtimin e ligjshmërisë së veprimeve dhe akteve administrative të ndërmarra nga institucionet përkatëse. Vlerësimi i ligjshmërisë së këtyre akteve dhe pasojave të tyre juridike i përket organeve kompetente gjyqësore dhe, në mungesë të indicieve të mjaftueshme për trajtim të diferencuar të bazuar në një shkak të mbrojtur, nuk përbën, në vetvete, provë të diskriminimit.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm për të krijuar prezumimin e një trajtimi diskriminues në kuptim të ligjit.

Komisioneri vlerëson se pretendimet mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor, marrëdhëniet e punës, funksionimin e ambienteve institucionale dhe çështjet organizative-procedurale lidhen me ushtrimin normal të kompetencave administrative të shkollës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Shqetësime të përgjithshme, të mbështetura në qëndrime apriori dyshuese ndaj veprimeve të shkollës, pa u bazuar në rrethana konkrete dhe të individualizuara, nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme objektive për të konkluduar mbi parregullsi institucionale.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri është njëkohësisht diskriminuese. Një sjellje diskriminuese është gjithmonë e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese kundër SHMB 9- vjeçare “Oso Dauti” Llugaj, znj. Violeta Çakraj, nuk mund të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar dhe

për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, si dhe nenin 33, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues znj. A. A., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)